

VENDIM
Nr.634, datë 23.7.2010

**PËR KALIMIN NË PËRDORIM TË MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS, RINISË
DHE SPORTEVE, TEATRIT KOMBËTAR TË OPERËS DHE BALETIT E ANSAMBLIT
POPULLOR, TË OBJEKTIT NR.19 “GODINA E SINOPTIKËS SË VJETËR”, PJESË E
PRONËS NR.109, “ISH-UZINA E ARTILERISË” NË BRARË, TIRANË, NË ADMINISTRIM
TË MINISTRISË SË MBROJTJES**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes dhe Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përdorim të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për Teatrin Kombëtar të Operës dhe Baletit e Ansamblin Popullor, të objektit nr.19 “Godina e sinoptikës së vjetër”, me sipërfaqe 980.4 (nëntëqind e tetëdhjetë pikë katër) m², pjesë e pronës nr.109 “ish-Uzina e Artilerisë”, pronë në administrim të Ministrisë së Mbrojtjes, me qëllim magazinimin e dekoreve të shfaqjeve, deri më 31 dhjetor të vitit 2020.

2. Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Teatrit Kombëtar të Operës dhe Baletit dhe Ansamblit Popullor u ndalohet ta ndryshojnë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojnë atë ose t’ua japin në përdorim të tretëve.

3. Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të nxjerrin aktet e nevojshme për dhënien në përdorim të objektit, duke përcaktuar detyrimet për secilin institucion.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

